



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 1.4.2021

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 1.4.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Pasi u njohëm me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat bashkëlidhur tyre, përcjellë nga ana e Kolegjit në datën 17.3.2021, duke i analizuar ato në raport me secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se shkaqet e ankimit mbeten për t’u marrë në shqyrtim e për t’u gjykuar nga ana e këtij trupi gjykues, duke parashtruar si vijon:

### **I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë**

**1.** Për sa i përket shkaqeve të ankimit për pasurinë “**Apartament**”, me sipërfaqe **124,91m<sup>2</sup>** me adresë rruga “\*\*\*.\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka prapësuar si vijon:

1.1 *Lidhur me koston e ndërtimit të objektit shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268,2 m<sup>2</sup>.*

1.2 *Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, pretendoi se: “... Përveç vlerës së ndërtimit në shumën 4.754.112 lekë, janë bërë edhe disa pagesa në lidhje me projektet (inxhinierike, hidraulike, elektrike) në shumën 245.888 lekë, pra në total kostoja e shtëpisë private është në vlerën 5.000.000*

lekë...”. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë (prova nr. 1<sup>1</sup>) deklaratën fillestare të pasurisë të babait të bashkëshortes së tij, z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e subjektit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 22.3.2004.

1.3 Referuar përmbajtjes së kësaj deklarate, z. \*\*\*.\*\*\*, ndër të tjera, në seksionin e përshkrimit të pasurisë, ka deklaruar: *“Tokë 330 m<sup>2</sup>”, me vlerë 0,66 milion lekë dhe “ndërtesë banimi 100 m<sup>2</sup>”, me vlerë 5 milionë lekë, pjesa takuese 100%, adresa fshati \*\*\* në Komunën Dajt. Burimi i krijimit për këto pasuri është deklaruar: (i) Shitje banese në Peshkopi, 2 milionë lekë dhe (ii) të ardhurat personale “paga”, për 2 vjet, në shumën 3.6 milionë lekë.*

1.4 Bazuar në sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se deri në datën 22.3.2004, kur është dorëzuar kjo deklaratë nga babai i bashkëshortes së subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, është deklaruar si vlerë investimi shuma 5.000.000 lekë. Ndërkohë, marrë në konsideratë edhe aktet dhe provat e administruara në dosje të Komisionit, rezulton që pas kësaj date (mars 2004), është kryer edhe një pagesë tjetër, në datën \*\*\*.7.2004<sup>2</sup>, në shumën 377.022 lekë, e cila duhet t’i shtohet vlerës së investimit të deklaruar.

1.5 Gjithashtu konstatojmë se në provën e paraqitur nga subjekti, deklaratën e pasurisë të z. \*\*\*.\*\*\*, deklarohet edhe një autoveturë e tipit “Ford Fiesta”, me vlerë 400.000 lekë, me pjesë takuese 100% dhe burim krijimi: të ardhura personale “paga”, në shumën 1.2 milionë lekë.

1.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, përveç sa kemi parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi, dhe nëse Kolegji do ta vlerësojë të pranueshme kërkesën për kryerjen e një analize financiare lidhur me pasurinë: *shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268,2 m<sup>2</sup>*, shuma prej 400.000 lekë duhet të përfshihet si shpenzim/investim në këtë analizë.

1.7 *Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga fondacioni “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”*

1.8 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Siç kam shpjeguar më parë..., bashkëshortja, znj. \*\*\*.\*\*\*, i ka ofruar shërbime konsulence financiare fondacionit “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”, duke pretenduar se: “... për shkak të kohës shumë të largët (mbi 15- vjeçare) bashkëshortja nuk ka ruajtur dokumentacionin në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi... dhe është e pamundur paraqitja e dokumentacionit të plotë, si kontratat për vitet 2002 dhe 2003, dhe specifikimin në lidhje me pagesën e tatimit në burim etj.”.*

1.9 Subjekti, për të vërtetuar shërbimin e ofruar nga bashkëshortja pranë këtij fondacioni, bashkëlidhur parashtrimeve të tij, ka depozituar si provë (provat nr. 2, 3, 4 dhe 5): (i) nxjerrje llogarie bankare të pjesshme dyemërore, të z. \*\*\*.\*\*\* dhe z. \*\*\*.\*\*\*, për vitin 2003, dhe nxjerrje llogarie të pjesshme të fondacionit “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”, për vitin 2004. Nga të dyja llogaritë bankare, nga \*\*\*.\*\*\*.\*\*\* Bank, duket se janë filtruar vetëm veprimet tërheqje me përshkrimin: *“... Cheque Withdrawal... \*\*\*.\*\*\*”*; (ii) një komunikim me email i datës \*\*\*.12.2003, midis bashkëshortes së subjektit, znj. \*\*\*.\*\*\* dhe z. \*\*\*.\*\*\*, si dhe një letër rekomandimi nga ky i fundit për znj. \*\*\*.\*\*\*, e cila mban datën \*\*\*.4.2004. Theksojmë se letra e rekomandimit është

<sup>1</sup> Referuar listës së provave (gjithsej 12) të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur parashtrimeve të tij të datës 17.3.2021.

<sup>2</sup> Referohuni shkresës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018.

format i thjeshtë A4 dhe nuk ka elemente të tjera provueshmërie (nënshkrimin); si dhe (iii) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.4.2004, për miratimin e z. \*\*\*.\*\*, në detyrën e Drejtorit të degës të “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*”.

1.10 Në vlerësim të provave si më sipër, Komisioneri Publik çmon se ato nuk arrijnë të provojnë të ardhurat e deklaruara nga punësimi i personit të lidhur, bashkëshortes, pranë fondacionit “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*”, në vitet 2002-2003, si dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

1.11 Për sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat e deklaruara të përfituara nga fondacioni “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*”, në vitin 2004, bazuar në kontratën e shërbimit të datës \*\*\* janar 2004, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se: “... *megjithëse ngarkesën për tatimin në burim për shërbimet e konsulencës e ka pasur bashkëshortja, kjo pagesë është llogaritur, mbajtur dhe paguar nga subjekti “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*”*. Subjekti për të mbështetur këtë pretendim, ka depozituar (prova nr. 6) shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2004, që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i drejton Dhomës \*\*\* të Tregtisë.

1.12 Komisioneri Publik vlerëson se shkresa e DPT-së, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2004, nuk është relevante, pasi ajo është një korrespondencë e ndjekur midis DPT-së dhe Dhomës \*\*\* të Tregtisë. Gjithashtu, vlerëson të theksojë, se në kontratën e shërbimit të administruar në dosjen e Komisionit, nënshkruar nga z. \*\*\*.\*\*.\* dhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, kjo e fundit, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, ka detyrimin për të mbuluar të gjitha detyrimet tatimore që lidhen me pagesat në favor të saj (neni 4 i kontratës). Për më tepër, rezulton se shumica e tatimit në burim që është paguar nga “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*”, në vitin 2004, në total në shumën 61.563 lekë, nuk korrespondon me detyrimin që ka lindur nga kjo kontratë shërbimi, si dhe është më e ulët se vlera e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit gjatë vitit 2004<sup>3</sup>.

1.13 Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga personi i lidhur me të, bashkëshortja, pranë fondacionit “\*\*\*.\*\*.\*.\*\*\*.\*\*\*” për vitin 2004, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

1.14 *Lidhur me shpenzimet e qirasë dhe të mobilimit të familjes së bashkëshortes së subjektit*

1.15 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar se për mobilimin e shtëpisë private janë përdorur mobiliet e shtëpisë në Peshkopi, ndërsa lidhur me shpenzimet e qirasë ka deklaruar se familja e bashkëshortes, për periudhën 1996 deri në vitin 2003, ka jetuar në katin përdhës të shtëpisë së mikut të babait të saj, z. \*\*\*.\*\*, pa pagesë. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur si provë (prova nr. 7) deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2021, me anë të së cilës shtetasi \*\*\*.\*\*.\* (djali i z. \*\*\*.\*\*) deklaroi se z. \*\*\*.\*\*.\* dhe familjarët e tij, nga viti 1996 deri në vitin 2003, kanë jetuar në shtëpinë e babait të tij pa pagesë.

---

<sup>3</sup> Subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit ka deklaruar se në lidhje me këto të ardhura është mbajtur dhe paguar tatimi në burim në masën 10%, që për vitin 2004 llogaritet në vlerën 10% x 63.250 lekë \*12 muaj = 75.900 lekë.

1.16 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, përmbajtja dhe provueshmëria e kësaj deklarate noteriale, paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, e vetme dhe e pa mbështetur në prova të tjera, duhet të merret me rezervë në vlerësimin dhe analizën e mbulimit me burime të ligjshme të pasurisë: *shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip 268,2 m<sup>2</sup>*.

**2. Për sa i përket shkaqeve të ankimit për pasuritë “Apartament”, me sipërfaqe 29,86 m<sup>2</sup> dhe “Garazh” me sipërfaqe 12,5 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*.\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, Tiranë**

2.1 *Lidhur me kredinë bankare në shumën 23.000 euro*

2.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“... në thelb, z. \*\*\*.\*\*\* i janë kthyer fondet e papërdorura, por për të shmangur kostot e një deklarate të re noteriale në lidhje me kthimin e shumës së marrë hua prej tij dhe për të provuar, dhe për të shmangur në çdo rast çdo pretendim të mundshëm nga z. \*\*\*.\*\*\*, në të ardhmen është vepruar me likuidimin përmes bankës të kësaj shume”.*

2.3 Komisioneri Publik i vlerëson jo bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin për të shmangur kostot e një deklarate të re noteriale, vlerësojmë se shpenzimet e marrjes së kredisë janë disa herë më të larta krahasuar me shpenzimet noteriale për përpilimin e një deklarate të re. Sa më sipër, bazuar dhe në informacionin e depozituar nga \*\*\* Bank, rezulton se shuma e marrë kredi pranë kësaj banke duket se ka shërbyer për shlyerjen e huas kundrejt z. \*\*\*.\*\*\* dhe jo sikundër deklarohet për blerjen e apartamentit me sip. 102 m<sup>2</sup>, me adresë rruga e “\*\*\*”, Linzë, Tiranë. Gjithashtu, në gjendjen që janë aktet e administruara, nuk provohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja e tij ka pasur për qëllim ndërtimin e një objekti banimi nga ana e saj.

2.4 *Lidhur me shumën 20.000 euro, që ka shërbyer për shlyerjen e kredisë bankare të marrë nga personi i lidhur, bashkëshortja, në vitin 2004*

2.5 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“... kjo shumë nuk mund të konsiderohet si një shumë e dhuruar për sa bashkëshortja, në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve, në vitin 2008, ishte pjesë e trungut familjar së bashku me prindërit dhe vëllain e saj, si dhe kontribuese në mënyrë të vazhdueshme në ekonominë familjare”.*

2.6 Komisioneri Publik, përveç sa kemi parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi, konstaton se ka mospërputhje referuar provave të administruara, duke i konsideruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit jo bindëse. Referuar provës së paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit (prova nr. 1), deklaratës së pasurisë të z. \*\*\*.\*\*\*, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 22.3.2004, ky i fundit ka deklaruar pjesë takuese 100 % dhe burim krijimi për pasurinë “tokë 330 m<sup>2</sup>” dhe “ndërtesë banimi me sip. 100 m<sup>2</sup>” në fshatin \*\*\*, Komuna Dajt, ka deklaruar: (i) *shitje banese në Peshkopi, 2 milionë lekë* dhe (ii) *të ardhurat personale, “paga”, për 2 vjet, në shumën 3.6 milionë lekë.*

2.7 Ndërsa, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 5.4.2006, ka deklaruar për këto pasuri si pjesë takuese 25%.

2.8 Sa më sipër, Komisioneri Publik, sikundër ka parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi, konstaton se bashkëshortja e subjektit ka përfituar rreth 55% të të ardhurave të realizuara nga shitja e kësaj pasurie, situatë faktike, e cila nuk përputhet me deklaratimet respektive mbi pjesën takuese, si nga personi i lidhur, bashkëshortja dhe babai i saj.

2.9 *Lidhur me kursimet familjare në shumën 9.000 euro*

2.10 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të prapësimeve të tij të datës 17.3.2021, ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2021, të ISSH-së (prova nr. 8), nga e cila dalin të dhëna mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për familjarët e bashkëshortes së tij, respektivisht për të vëllain, për periudhën 2005-2006, dhe nënës së saj për vitin 2005.

2.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, prova e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi duhet pranuar dhe marrë në konsideratë në funksion të analizës dhe kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të shumës 9.000 euro.

2.12 *Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 102 m<sup>2</sup>*

2.13 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: “... ky është një veprim i ndodhur në vitin 2007 dhe pakujdesia ka ardhur më së shumti se, megjithëse në gjuhën e përditshme bëhej fjalë për shitjen e një pasurie të paluajtshme (apartament), në aspektin juridik është realizuar shitja e të drejtave reale mbi këtë pasuri. Rregulli i përgjithshëm se shitja e pasurive të paluajtshme nuk mund të realizohej pa paguar tatimin në burim për shkak të ZVRPP-së, e cila në këtë rast vepron si agjent tatimor, ka krijuar përceptimin të bashkëshortja në atë kohë se çdo veprim ishte realizuar në përputhje të plotë me ligjin. Në të njëjtën kohë mbetet i rëndësishëm fakti se ky nuk është një fenomen i cili më ka vënë mua në kushte të vazhdueshme paligjshmërie, përderisa unë nuk kam pasur dijeni, pasi shitja e këtyre të drejtave reale ka ndodhur disa vite para martesë...”.

2.14 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shkaqet e ankimit në këtë rast janë në kuadrin e kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (apartament, me sip. 29,86 m<sup>2</sup> dhe garazh, me sip. 12,5 m<sup>2</sup>).

2.15 Në funksion të këtyre shkaqeve, bazuar në kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se fitimi i realizuar nga personi i lidhur në shumën 18.000 euro, nuk konsiderohet si e ardhur e ligjshme, pasi rezulton se për këto të ardhura, nuk janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit të tyre.

**3. Për sa i përket shkaqeve të ankimit për pasurinë: Apartament “duplex” me sip. 205,33 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 521,8 m<sup>2</sup>, ndodhur në kompleksin rezidencial “\*\*\*”, Lalëz/Durrës**

3.1 *Lidhur me burimin e deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 48,27 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, në shumën 35.000 euro*

3.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup> në rrugën

“\*\*\*.\*\*\*”, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... ish-bashkëshortja para martesë jetonte me familjen e saj dhe, sipas dijenisë time në atë kohë, prindërit e saj ishin të punësuar në administratë publike, ndërsa i vëllai ishte emigrant në Itali. Në lidhje me diferencën negative prej 225.245 lekë kam theksuar pamundësinë time për të provuar burimet e këtyre të ardhurave nga ish-bashkëshortja apo familja e saj”.

3.3 Komisioneri Publik vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Duke iu referuar përmbajtjes së deklaratës së parë të subjektit të rivlerësimit, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në datën 18.3.2004, rezulton se si burim krijimi për pasurinë *Apartament me sip. 73 m<sup>2</sup>*, në rrugën “\*\*\*.\*\*\*”, janë deklaruar vetëm “kursimet familjare”, pra të tij dhe të bashkëshortes. Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar burim tjetër në formën e ndonjë kontributi apo dhurimi nga të ardhurat e realizuara nga familja e ish-bashkëshortes së tij.

3.4 Për sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave, në shumën 2.900.000 lekë, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka sqaruar elementet që janë reflektuar në shumën 2.900.000 lekë, shumë e cila është përfituar më pas si rrjedhojë e pjesëtimit të pasurisë nga zgjidhja e martesës, duke paraqitur si provë (prova nr. 9) edhe një kërkesëpadi, që mban datën \*\*\*.1.2006.

3.5 Komisioneri Publik vlerëson se kjo provë e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën, për sa kemi parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi. Në gjendjen që janë aktet, duket se nuk justifikohet bindshëm burimi i ligjshëm i shumës 2.900.000 lekë, e cila ka si origjinë regjimin pasuror martesor në bashkësi<sup>4</sup> të ish-bashkëshortëve Selita.

3.6 *Lidhur me burimin e deklaruar kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në shumën 30.000 euro, krijuar para martesë*

3.7 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij datë 17.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... edhe shuma 30.000 euro, e cila është marrë në momentin e ndarjes nga trangu familjar, është pjesë e një kontributi të vazhdueshëm në familje për të gjitha vitet kur bashkëshortja ka jetuar me familjen e saj”.

3.8 Komisioneri Publik vlerëson t’i qëndrojë shkaqeve të ankimit, duke konstatuar se shumat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit, pas shitjes së pronës në titull pronësie të babait të saj, zënë rreth 55% të të ardhurave të realizuara nga kjo shitje, situatë faktike, e cila nuk përputhet me deklaratimet respektive mbi pjesën takuese, si nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, dhe babai i saj.

3.9 Kujtojmë se të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, nga shitja e pasurisë: *Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip 268,2 m<sup>2</sup>*, kanë shërbyer më pas dhe deklarohen si burim krijimi pasurie në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të. Për kontrollin e ligjshmërisë së këtij burimi, në një rast tjetër, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se: *[... duke pasur parasysh parashikimin e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me objektin e vlerësimit të pasurisë, sipas të cilit ... është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i*

---

<sup>4</sup> Për më tepër, lidhur me bashkësinë ligjore martesore, përbërjen, të drejtat dhe detyrimet respektive të bashkëshortëve etj., referohuni në Kreun II, “Regjimi pasuror martesor në bashkësi”, nenet 73 e në vijim të Kodit të Familjes.

*përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij ... çmon se këto elemente rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë pjesë e objektit të kriterit të kontrollit të pasurisë edhe ligjshmëria e burimit të krijimit, detyrimisht duhet të analizohen veçmas edhe pasuritë të cilat kanë shërbyer si burim i krijimit të një pasurie tjetër, proces i cili, jo pa qëllim, e fillon analizën që nga viti 2003.]<sup>5</sup>*

#### **4. Për sa i përket shkaqeve të ankimit për pasurinë **Autoveturë****

4.1 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, lidhur me burimin e krijimit, për shumën 4.000 euro, të deklaruar si dhuratë nga vëllai, \*\*\*.\*\*\*, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“... vëllai vetëm, në fillim të vitit 2009, ka mundur të pajiset me leje qëndrimi në shtetin italian dhe kjo është arsyeja që pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga puna në ndërtim ka filluar në këtë periudhë”.*

4.2 Referuar këtij pohimi të subjektit, si dhe në mungesë të ndonjë prove tjetër, Komisioneri Publik, përveç sa kemi parashtruar lidhur me këtë shkak ankimi, referuar kërkesave të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, konstaton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga dhuruesi, vëllai i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2009, duket se janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe dhurimin e shumës 4.000 euro.

## **II. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale**

5. Për sa i përket shkaqeve të ankimit lidhur me: (i) çështjet në të cilat subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit (rasti “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”) dhe (ii) çështjet në të cilat subjekti i rivlerësimit duket se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në dukje<sup>6</sup>, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, subjekti i rivlerësimit, pasi analizon përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, ndër të tjera, ka prapësuar se: *“...nuk kam qenë në kushtet e nenit 72/6 të K. Pr. Civile, pasi nuk kam pasur asnjë arsye njëanshmërie e për më tepër arsye serioze njëanshmërie... si dhe “... nuk ka asnjë rast ku unë të kem marrë pjesë në gjykimin e çështjeve me palë organet tatimore, ku të ketë ekzistuar njëri nga dy kushtet...”*, duke përmendur institutin e përfaqësimit dhe aktet e mundshme të konceptuara apo nënshkruara nga personi i lidhur, bashkëshortja. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka paraqitur si provë të re (prova nr. 10 dhe 11), dy kontrata të ngjashme të lidhura ndërmjet personave të tjerë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2021, të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës - Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

5.1 Komisioneri Publik, në vlerësim të përmbajtjes dhe qëllimit të provueshmërisë të akteve si më sipër, në raport me shkaqet e ankimit, çmon se shkresa e agjencisë shtetërore nuk është relevante dhe e nevojshme për konstatimin e ndonjë situatë faktike në ndihmë të këtij gjykimi.

<sup>5</sup> Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 10/2019, prg. 57.1.

<sup>6</sup> Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me palë procedurale, administratën qendrore e vendore të tatim-taksave, në të cilat personi i lidhur me të, bashkëshortja, ka ushtruar funksione në rolin drejtues apo funksione të tjera.

5.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shkaqet e ankimit në këtë rast mbi konfliktin e interesit duhen shqyrtuar nga një këndvështrim objektiv, nëse subjekti i rivlerësimit, në gjykimin e çështjeve si më sipër, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm mbi paanësinë e tij.

5.3 Në këtë drejtim vlen t'i referohemi jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila, në çështjen *Piersack kundër Belgjikës*, përshkroi qasjen e saj ndaj paanësisë. Paanësia, normalisht, shënon mungesë parajgykimesh ose ndikimi, e cila vlerësohet midis qasjes subjektive dhe qasjes objektive. Vështirësia për të vërtetuar mungesën e paanësisë personale (subjektive) ka bërë që Gjykata, në jurisprudencën e saj, të përqendrohet në qasjen objektive, e cila përcakton nëse një gjyqtar ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm për mungesën e paanësisë. Në këtë mënyrë, Gjykata ka prezantuar *nacionin e paraqitjeve*, duke vlerësuar *se ajo që është në lojë, është besimi që gjykatat duhet të frymëzojnë te publiku në një shoqëri demokratike*.

5.4 Në lidhje me nocionin e paraqitjeve dhe paanshmërisë, nën dritën e parimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së GJEDNJ-së, si dhe qëllimit të shprehur nga neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës, rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, Kolegji, tashmë, ka një praktikë të konsoliduar në të cilën, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se: [... *lidhur me paanshmërinë, "gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë aparençën e paanshmërisë"*]<sup>7</sup>.

5.5 Duke pasur parasysh, sa më lart, Komisioneri Publik, përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, vlerëson se, duke marrë pjesë dhe gjykuar në cilësinë e relatorit të çështjes, ku palë ndërjyqëse kanë qenë subjekte me të cilët, si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë pasur si para dhe pas gjykimit të çështjes, marrëdhënie juridiko-civile, të cilat në themel të tyre kanë pasur interesa pasurore, kjo situatë faktike e konstatuar duket se përbën konflikt interesi, në vështrim të nenit 5<sup>8</sup> të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe duket si mungesë paanësie, referuar nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa lidhur me çështjet e konfliktit të interesit në dukje, i qëndrojmë shkaqeve të paraqitura, në të cilat vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka paraqitur në të gjitha rastet dorëheqjen dhe në disa raste ka qenë i vonuar, me qëllim shmangien e çdo perceptimi mbi paanshmërinë e gjykimit prej tij.

6. Për sa i përket denoncimeve të publikut, përveç sa kemi parashtruar si shkaqe ankimi lidhur me to, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në ato denoncime, të administruara dhe të përcjella nga Kolegji, për të cilat çmon se përmbajnë elemente të mjaftueshme referuar kërkesave të nenit

<sup>7</sup> Për më tepër referohuni në vendimet (JR) nr. 9/2018, nr. 10/2019 dhe nr. 16/2019.

<sup>8</sup> Referuar nenit 5, pika 1e ligjit nr. 9367/2005: "1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni".



53 të ligjit nr. 84/2016, e që mund të vlejë si për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ashtu dhe për një vlerësimi tërësor të çështjes.

7. Subjekti i rivlerësimit mbajti qëndrim dhe prapësoi për secilin shkak dhe denoncim të publikut (12 denoncime), në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021. Komisioneri Publik vlerëson se analizimi i këtyre rasteve përfshihet brenda kompetencës së organeve të rivlerësimit për të matur indikatorin e njohurive ligjore të subjektit, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe jo vetëm, në funksion të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit, referuar parashikimeve të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, duke mos përfshirë gjykimin apo vlerësimin mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së subjektit<sup>9</sup>.

8. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se:

8.1 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për rastin e denoncimit nga një grup gjyqtarësh, nuk janë bindëse. Në gjykimin e këtij rasti, nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, në vëmendje edhe të rekomandimit të ONM-së, duket se mangësitë e vërejtura nga Komisioni<sup>10</sup> janë të tilla që duhen vlerësuar brenda kuadrit të procesit të rivlerësimit dhe jo t'i transferohen organit kompetent për inspektim, sikurse ka vendosur në përfundim Komisioni.

9. Lidhur me denoncimin e shtetases \*\*\*.\*\*\*, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“...Rezultoni në rastin konkret që pala paditëse në padinë fillestare, përmes së cilës ka kërkuar dëmshpërblim, nuk i ka kundërshtuar VKM-të respektive, gjë të cilën ajo e ka bërë vetëm në datën \*\*\*.3.2014, me anë të kërkesës së saj për saktësimin e objektit të padisë. Në këto rrethana, në kushtet kur ajo ka qenë në dijeni që në kohën e ngritjes së padisë fillestare (\*\*\*.7.2012), të akteve administrative... dhe ajo nuk i ka kundërshtuar këto akte asnjëherë deri në datën \*\*\*.3.2014 (kur është saktësuar objekti i padisë)... Gjykata ka vlerësuar padinë të parashkruar...”*

9.1 Duket se subjekti i rivlerësimit, në llogaritjen e afateve ligjore të ngritjes së padisë, i jep rëndësi jo momentit të ngritjes dhe marrjes dijeni të faktit cenes nga pala paditëse, por momentit të saktësimin të saj. Eventualisht, në një situatë procedurale të tillë, saktësimi i objektit të padisë, brenda objektit dhe thelbit të kërtimeve parësore, nëse ato janë në afat, nuk do të përbënte padi të re, dhe nga ky moment të llogaritej afati sipas përcaktimeve ligjore të rastit, objekt konflikti gjyqësor.

---

<sup>9</sup> Referuar nenit 72/4, të ligjit nr. 96/2016, “vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

<sup>10</sup> (i) Ekzistenca e mospërputhjeve mes kërimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës ...; (ii) Roli aktiv i gjykatës/subjektit, lidhur me saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke detyruar KLP-në të bëjë emërimin e paditësit si prokuror; (iii) Tejkallimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces; dhe (iv) Mosarsyetimin e rolit dhe kompetencave të palës ndërgjyqëse/KLP-së, në momentin e zëvendësimit të saj, sipas ligjit nr. 96/2016.

9.2 E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt<sup>11</sup>.

9.3 Duke iu rikthyer rastit objekt denoncimi, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, por me arsyetim të ndryshëm, duke rrëzuar padinë e denoncueses si të ngritur jo brenda afatit ligjor. Të dyja gjykatat, duke iu referuar së njëjtës bazë ligjore, nenit 24, pika 1<sup>12</sup> e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, arrijnë në konkluzione të ndryshme mbi momentin e marrjes dijeni nga paditësi të faktit cenes dhe saktësimin të objektit të padisë. Megjithatë në gjykimin në shkallë të parë është pranuar saktësimi i objektit të padisë, referuar nenit 185 të K. Pr. Civile, si dhe është provuar se pala e paditur nuk ka sjellë asnjë akt mbi njoftimin e drejtpërdrejtë të palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, vlerëson ndryshe.

9.4 Për sa më sipër vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, nuk janë bindëse, e për pasojë elementet e dala nga ky denoncim, së bashku me shkaqet e ankimit, do duhet të hetohen dhe vlerësohen më tej nga Kolegji, në referencë të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

**10.** Lidhur me denoncimin nga shtetasit \*\*\*.\*\*\*, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: “... *pretendimet e denoncuesit janë të pabazuara në rrethanat e faktit, si dhe në përcaktimet e ligjit*”.

10.1 Komisioneri Publik, duke e konsideruar me rëndësi që në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përmbytjes së denoncimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe akteve bashkëlidhur tij, konstaton se, në referencë të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, duket se subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, posaçërisht lidhur me fuqinë detyruese për zbatim të vendimeve të gjykatave më të larta, respektimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, nenit 64 të tij, si dhe respektimin e parimeve të pranuar të së drejtës, siç është parimi i gjësë së gjykuar, *res judicata*, duke passjellë zvarritje të panevojshme të procesit gjyqësor, në cenim të interesave të palëve ndërgjyqëse.

10.2 Nga aktet bashkëlidhur denoncimit rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ka marrë vendimin “Mbi ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës para Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë”, me nr. \*\*\* Regjistri Themeltar, datë \*\*\*.2.2017,

---

<sup>11</sup> Për më tepër, shih vendimin nr. 6/2005 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>12</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësim u njoftohet nga ministria kompetente drejtpërdrejt pronarëve të shpronësuar... të cilët vetëm lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

megjithëse ndërkohë, sikurse pranon dhe subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, mbi bazën e ankimit të palës së paditur, Gjykata e Lartë, me vendimin e saj me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila kishte vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

10.3 Më pas, Gjykata e Lartë, tashmë Kolegji Administrativ, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.1.2018, në zgjidhjen e çështjes së kompetencës lëndore midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ngritur nga kjo e fundit, ndër të tjera, ka vlerësuar se: *“... për sa kohë kemi një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë...datë \*\*\*.12.2016, i cili ka zgjidhur në themel konfliktin e kompetencës lëndore, atëherë jemi përpara gjësë së gjykuar. Në këto kushte çështja objekt gjykimi, për këtë shkak ligjor dhe për këtë objekt nuk duhet të ishte ngritur përsëri, pasi jemi përpara rastit që çështja është shqyrtuar njëherë nga Gjykata e Lartë... Prandaj, gjykatës së cilës i dërgohet çështja për shqyrtim nga një gjykatë më e lartë ka detyrimin imperativ të marrë dhe të shqyrtojë çështjen dhe jo të ngrejë përsëri konfliktin e kompetencës/juridiksionit”*.

10.4 Për sa më sipër, në referencë edhe vendimit të Kolegjit (JR) nr. 28/2020, në të cilin është vlerësuar se: *[... qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre...]*, çmobjmë se elementet e dala si më sipër nga aktet bashkëlidhur këtij denoncimi, do duhet të hetohen dhe vlerësohen më tej nga Kolegji, bazuar në nenin 72, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

**11.** Lidhur me denoncimin nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“...shpjegimet e dhëna nga ana ime përpara KPK-së janë të plota dhe të qarta, ku, përveç të tjerash, kam shpjeguar në mënyrë të detajuar se kërkimet e paditësit \*\*\*.\*\*\* i referoheshin një baze ligjore të shpallur anktikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 12/2000 (faza e nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993) dhe, si e tillë, nuk kishin shkak ligjor bazuar në legjislacionin në fuqi”*.

11.1 Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së këtij denoncimi dhe akteve bashkëlidhur tij, konstaton se edhe në këtë rast, në referencë të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, duket se subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, posaçërisht lidhur me fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese<sup>13</sup> dhe aftësisë për të analizuar jurisprudencën.

11.2 Nga aktet e administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, me anë të vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë \*\*\*.12.2015, ndër të tjera, pasi ka vlerësuar se: (i) kërkimi i paditësit \*\*\*.\*\*\* është bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.12.1994, të KKKP, Bashkia Korçë, ku përcaktohet se shteti i detyrohet qytetarit \*\*\*.\*\*\* (trashëgimlënësi i paditësit) për masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit të shtëpisë të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve sipas kontratës së shitblerjes, referuar nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993 “Për

---

<sup>13</sup> Referuar vendimit nr. 5/2001, të Gjykatës Kushtetuese, kjo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se vendimet e saj: *“... kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit”*.

kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, se (ii) Gjykata Kushtetuese... ka vendosur: “Të shfuqizojë si të papajtueshëm me Kushtetutën, frazën që përmban neni 10, paragrafi I, i ligjit nr. 7698...”, me përmbajtjen: “... ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve”, si dhe (iii) duke qenë se paditësi nuk i ka ushtruar të drejtat e tij për të gëzuar statusin e qytetarit të pastrehë apo të qiramarrësit në banesën e kthyer ish-pronarit, nuk passjell detyrimin e Ministrisë së Financave, Degës së Thesarit apo ndonjë organi shtetëror për të kërkuar vlerën e një pasurie, për të cilën paditësi nuk rezulton që të ketë pasur të drejta pronësie; ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe rrëzimin e padisë.

11.3 Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi të vendimit si më sipër, në raport me atë që ka vendosur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 12/2000, si dhe të një rasti analog të zgjidhur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në korrik të 2014, konstatojmë se në këtë rast, në mënyrën si është arsyetuar dhe argumentuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, duket se paraqiten defekte, pasi:

11.4 *Së pari*, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 12/2000, është e vërtetë që ka shfuqizuar një pjesë të nenit 10, paragrafi I, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, por ajo pjesë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë *me masën e shpërblimit* për ndërtesat ish-pronë private, që janë tjetërsuar nga persona të tretë, duke mos cenuar të drejtën e këtyre të fundit, të cilët, mbi bazë kontratash të ligjshme, kanë blerë këto pasuri, e më pas për shkak të ligjit, i kanë humbur, pasi i janë rikthyer ish-pronarëve. Jo pa qëllim, duke bërë këtë shfuqizim, Gjykata ka vlerësuar se i takon organit që ka iniciativën ligjvënëse dhe organit ligjvënës, që, në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi, të bëjnë plotësimet përkatëse të dispozitës së nenit 10, paragrafi I të ligjit të sipërcituar.

11.5 Në mungesë të këtyre plotësimeve, sikurse ka ndodhur, referuar nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile, “Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.” Në këtë kuadër, gjykata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese<sup>14</sup>.

11.6 Roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të zgjidhë, pa qenë e detyruar dhe e lidhur me dispozitat ligjore të referuara nga paditësi, ka gjetur trajtim dhe unifikim në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2012, në të cilin, ndër të tjera, është mbajtur qëndrimi se: [... gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara... Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar].

---

<sup>14</sup> Për më tepër referohuni në vendimin nr. 28/2008 të Gjykatës Kushtetuese.

11.7 Së dyti, ndryshe nga sa ka argumentuar subjekti i rivlerësimit, se paditësi nuk gëzon më asnjë të drejtë kërkimi për kompensim, Gjykata Kushtetuese, në themel të arsyetimit të saj, ka vlerësuar se: “... **Mirëpo, ndërsa kjo vëmendje e shtetit për të shpërblyer personat e tretë nuk ka munguar, mënyra se si është zgjidhur kjo çështje nga neni 10, paragrafi I, nuk është në përputhje me Kushtetutën.** Duke u shpërblyer personat e tretë me çmimin e blerjes të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, ligji nuk i ka vënë këto dy kategori personash në një shesh barazie, përkundrazi, **kategoria e personave të tretë është vënë në pozita pabarazie dhe diskriminuese, gjë që passjell pamundësinë e saj të hyjë në qarkullimin civil për të siguruar një banesë tjetër.** Rregulli për masën e shpërblimit, sipas nenit 10, paragrafi I (çmimi në kohën e blerjes i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, kur ky indeksim do të llogaritet sipas nenit 27 të ligjit në momentin e hyrjes në fuqi të tij), vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe, pikërisht për këtë shkak, kjo pjesë e nenit 10 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese. **Aq sa është e drejtë dhe kushtetuese kthimi i pronave ish-pronarëve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut d.m.th., vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari.** **Kjo zgjidhje, nga njëra anë, nuk lejon të preken interesat e personave të tretë dhe, nga ana tjetër, nuk lejon sigurimin e përfitimeve pasurore të papërligjura, sepse secili do të shpërblehet për aq sa i takon kundrejt objektit që dorëzon, duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet e bëra nga personat e tretë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e ndërtesave”.**

11.8 Së treti, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor si në rastin e denoncuesit, duke vlerësuar të njëjta rrethana si më sipër dhe efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. \*\*\* (nr. \*\*\*), datë \*\*\*.7.2014, pasi ka rishikuar mbi bazën e rekursit të Bashkisë Korçë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2009, të Gjykatës së Apelit Korçë<sup>15</sup>. Në marrjen e këtij vendimi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se: “... paditësi ka të drejtën ligjore të dëmshpërblehet për vlerën reale në bazë të çmimit të tregut për banesën në momentin e dorëzimit tek ish-pronari, kjo pasi: (i) paditësi e kishte fituar pronën në mënyrë të ligjshme nëpërmjet kontratës së shitblerjes ... dhe (ii) aq sa e drejtë dhe kushtetuese është kthimi i pronave ish-pronareve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është edhe sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë dhe të plotë të personave të tretë”... “Gjithashtu, kjo gjykatë, për një zgjidhje sa më të drejtë të konfliktit dhe duke qenë se çështja objekt gjykimi kërkonte njohuri të posaçme... ka caktuar ekspert, duke ndihmuar në këtë mënyrë dhe në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, pra në përcaktimin e saktë të vlerës reale të tregut...”.

11.9 Për sa më sipër vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, nuk janë bindëse, e për pasojë elementet e dala nga ky denoncim, së bashku me shkaqet e ankimit, do duhet të hetohen dhe vlerësohen më tej nga Kolegji, në referencë të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

<sup>15</sup> Kjo gjykatë, pasi ka rigjykuar çështjen, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke pranuar kërkesëpadinë dhe detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit vlerën e plotë reale të banesës...”.

**12.** Lidhur me denoncimin e Kantierit të Ndërtimit të Anijeve Vlorë, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“...Referuar objektit të ndryshëm të kërimit, si dhe përcaktimeve të nenit 151/1 të Kodit të Punës rezulton e qartë se pretendimi i Komisionerit është i pabazuar”*.

12.1 Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, nuk janë bindëse. Faktet e vlerësuara dhe shkakut i padisë në të dyja rastet ka qenë i njëjtë, pra ndërprerja e marrëdhënies së punës. Sikundër dhe e drejta subjektive mbi të cilën është bazuar padia në këto dy raste ka qenë e njëjtë, cenimi i marrëdhënies juridike të punës, si themeli i pretendimit të paraqitur nga paditësit. Megjithëse në të dyja rastet, ecuria dhe tipologjia e rregullimit të kësaj marrëdhënie individuale pune ka qenë e ngjashme, në njërin rast, subjekti e gjen të gabuar zgjidhjen e dhënë nga gjykata më e ulët, ndërsa, në rastin tjetër, e gjen të drejtë.

12.2 Në të dyja rastet, ankimi ka paraqitur vetëm pala e paditur, por në gjykimin e rastit të parë, me palë paditëse \*\*\*,\*\*\*, megjithëse Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje vetëm nga ankimi i palës së paditur, fakt i cili detyron gjykatën të shqyrtonte vetëm bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të pretendimeve të ngritura në ankimin e kësaj pale, gjykata me vendimin përkatës, ku subjekti i rivlerësimit rezulton në cilësinë e relatorit të çështjes, e zgjidh konfliktin ndryshe. Në këtë rast prish vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i njeh palës paditëse nga 3 muaj pagë, në 13.5 muaj pagë, dukshëm tej kufijve të kërimit të palës ankimuese dhe në disfavor të saj.

12.3 Komisioneri Publik vlerëson të theksojë se thelbi i sistemit tonë procedural civil lidhet me faktin se gjykata nuk e merr iniciativën për të zgjidhur mosmarrëveshje të tjera dhe tej atyre për të cilat palët i janë drejtuar gjykatës. Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilat shprehet gjykata është parimi bazë i së drejtës procedurale. Në këtë kontekst, nëse palët nuk kanë pretendime, nuk formulojnë drejt pretendimet e tyre apo gabojnë në formulimin e tyre, atëherë gjykata nuk mund të ndreqë pozitën e njëres palë, në dëm të palës tjetër.

**13.** Lidhur me denoncimin e \*\*\*,\*\*\*,\*\*\*,\*\*\*, (\*\*\*) (\*\*\*), subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 17.3.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“...Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykim, kishte për shqyrtim ankimin e palës paditëse dhe ankimin e palës së paditur dhe ishte e detyruar të vijonte gjykimin e çështjes mbi bazën e këtyre ankimeve. Në lidhje me pretendimin për rastin \*\*\*, Gjykata... ka zbatuar një detyrë të lënë nga Gjykata e Lartë, sipas orientimit të saj, në ndryshim nga rasti i denoncuesit...”*.

13.1 Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim, nuk janë bindëse dhe shteruese. Në analizë të përmbajtjes së këtij denoncimi dhe akteve bashkëlidhur tij, sërish mbetet e paqartë nëse në rigjykimin e çështjes për rastin me paditës \*\*\*,\*\*\*, ku subjekti i rivlerësimit rezulton në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, në kuptim të nenit 443 të K. Pr. Civile dhe nenit 46 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, afati i ankimit është vlerësuar dhe respektuar apo të metat e këtij mjeti ankimi të palës së paditur janë shëruar. Rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.1.2017, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se ankimi i palës së paditur prezumohet ligjërisht, se nuk është paraqitur asnjëherë në apel. Nga ana tjetër Kolegji konstaton se rekursi i palës së paditur nuk është ngritur për të ankimuar pjesën

*e procedimit dhe vendimit të shkallës së dytë, që ka vendosur të mospranojë për shqyrtim ankimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë... pala e paditur nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe, sakaq, vendimi i mospranimi të ankimit i gjykatës së shkallës së dytë ka marrë formë të prerë.*

13.2 Referuar këtij vendimi, e vetmja detyrë e lënë Gjykatës Administrative të Apelit është që në rigjykimin e çështjes, të marrë masa për të verifikuar nëse ka vullnet pala paditëse të ndjekë ankimin e tij apo jo dhe më tej, nëse ka, të shqyrtojë çështjen në themel dhe të zgjidhë meritorisht shkaqet që ka objekt gjykimi. Pra, në këtë rast, duhej të verifikohej vetëm vullneti i palës paditëse, ndërkohë Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, pasi ka vendosur riçeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor, kalimin në seancë gjyqësore, konstatimit se pala e paditur ka qenë në mungesë, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të kësaj pale, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e ankimit të palës së paditur... dhe rrëzimin e padisë.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**